

UDHËZIM
Nr. 2, datë 15.4.2019

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 180,
DATË 4.4.2019 “PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS
SË VLERËSUAR TË VITIT 2017, PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE”**

Në zbatim të pikës 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019 “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për llogaritjen e pensioneve”, me qëllim zbatimin e drejtë dhe unik të tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

UDHËZON:

1. Në zbatim të pikës 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së shumëës fillestare mujore të pensionit, është 3.7 për qind.

2. Për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve, me datë lindje së të drejtës pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018, “Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shtohen edhe me koeficientin 3.7 për qind, të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të sipërcituar, të cilat llogariten si vijon:

	Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar për pensionet me datë lindje të drejte 1.1.2018-11.4.2019	Koeficientët e indeksimi të bazës së vlerësuar për pensionet me datë lindje të drejte nga data 12.4.2019	Kufizimi i pagave pas indeksimit me koeficientet vjetorë sipas pikave 1 dhe 2
Para vitit 1994	8.76	9.084	78,000
1994	8.76	9.084	78,000
1995	7.05	7.311	78,000
1996	5.47	5.672	78,000
1997	5.47	5.672	78,000
1998	4.57	4.739	78,000
1999	3.71	3.847	78,000
2000	3.38	3.505	78,000
2001	2.89	2.997	78,000
2002	2.67	2.769	114,670
2003	2.39	2.478	114,670
2004	2.17	2.250	114,670
2005	1.97	2.043	114,670
2006	1.79	1.856	114,670
2007	1.71	1.773	114,670
2008	1.51	1.566	114,670
2009	1.39	1.441	114,670
2010	1.33	1.379	114,670
2011	1.28	1.327	114,670
2012	1.23	1.276	114,670

2013	1.18	1.224	114,670
2014	1.18	1.224	114,670
2015	1.02	1.058	114,670
2016	1.02	1.058	114,670
2017	1.00	1.037	114,670
2018	1.00	1.000	114,670
2019	1.00	1.000	114,670

3. Në zbatim të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, në vitin 2019, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi nuk mund të jenë më të larta se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, 26,000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994-31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, 114,670 (njëqind e katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 48, datë 11.4.2019 dhe në zbatim të pikës 4, të këtij vendimi, indeksimi i pagave me koeficientët e pasqyruar në pikën 2 të këtij udhëzimi, për efekt të llogaritjes fillestare të pensioneve, do të bëhet vetëm për pensionet me datë lindje të së drejtës nga data 12.4.2019 e në vazhdim.

5. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018 “Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve”, mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë lindje së të drejtës në harkun kohor 1.1.2018–11.4.2019, përfshirë edhe këtë datë.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

7. Drejtorët Rajonal të marrin masa për organizimin e punës, me qëllim evidentimin dhe rishqyrtimin e pensioneve të caktuara, me datë lindje së të drejtës nga data 12.4.2019 e në vazhdim, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019 dhe udhëzimit në zbatim të tij.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Astrit Hado